

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Tonka Berishaj, kryetare, Dr.sc.Driton Muharremi e Have Haliti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Leonita Lajçi, procesmbajtëse, në çështjen penale të akuzuarit B.M. nga fshati ... „Komuna Viti, për shkak të dy veprave penale: , Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së, dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesat e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe mbrojtësit të akuzuarit B.M. të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.97/2018 datë 21.05.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 17.07.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe ajo e mbrojtësit të akuzuarit B.M., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.97/2018 datë 21.05.2018, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan-departamenti për krime të rënda, me aktgjykimin PKR.nr.97/2018 datë 21.05.2018, të akuzuarin B.M. e ka shpallur fajtor për veprën penale në vazhdim Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së, dhe për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, ashtu që për veprën penale nën pikën I i ka përcaktuar dënimin me gjobë në shumën prej 300 (treqind) euro dhe dënim burgu në kohëzgjatje prej 7(shtatë) muaj, ndërsa për veprën penale në pikën II i ka përcaktuar dënimin me gjobë në shumë prej 300(treqind) euro ashtu që i ka shqiptuar dënimin në kohëzgjatje prej 7(shtatë) muajve në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e qëndrimit në paraburgim prej 19.04.2018 e deri 18.05.2018 , dhe dënimin unik në shumën prej 600 (gjashtëqind) euro , të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Të akuzuarit i janë konfiskuar : substanca narkotike e llojit “heroinë” me peshë prej 1.2 (një pikë dy) gram, substanca e llojit “heroinë” me peshë prej 1.8 (një pikë tetë) gram dhe substanca e llojit “kokainë” me peshë prej 0.3 gram dhe armë- revole e llojit Zastava kalibër 6.35 mm, me numër serik T770743,një karikator dhe nëntë fishakë të kalibrit 6.35 mm .Është obliguar i akuzuari që t’i paguaj shpenzimet procedurale sipas llogaritjes përfundimtare të gjykatës, kurse në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 (tridhjetë) euro në afat prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë kanë paraqitur:

- Prokuroria Themelore në Gjilan, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin, duke propozuar që të ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë, ashtu që në vend të dënimeve të përmendura, ndaj të akuzuarit të shqiptohet një dënim më i lartë me burgim.

- Mbrojtësi i të akuzuarit, avokat B.I. për shkak të vendimit mbi dënimin, duke propozuar që të ndryshohet aktgjykimi i atakuar ashtu që ndaj të pandehurit të shqiptohet një dënim me burgim më të ulët, ose këtë dënim ta zëvendësojë me dënim me kusht, ashtu që i akuzuari brenda një periudhe verifikuese prej 2 viteve të mos kryejë vepër tjetër penale.

Gjykata e Apelit caktoi seancën e kolegjit, në të cilën ftoi palët, mirëpo Prokurori i Apelit, i akuzuari B.M., dhe mbrojtësi i tij av.B.I. nuk ishin prezent edhe pse të ftuar me rregull.

Prokurori i Apelit me parashtresën me shkrim PPA/I nr.274/18, të dt. 14.06.2018, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar, ndaj të akuzuarit të shqiptohet një dënim më i lartë kumulativ se sa me aktgjykimin e ankimuar dhe të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

- ankesat nuk janë të bazuara.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ankimohet nga ana e Prokurorisë për shkak të shkeljes esenciale të ligjit penal nga neni 383 par.1.2 të KPP-së, me rastin e vendosjes së çështjes penale juridike, pasi i akuzuari ka pranuar tri veprat penale të përcaktuara në aktakuzë, mirëpo prokuroria konsideron se gjykata ka vepruar j90 drejtë kur ka bërë kualifikimin e dy veprave penale në një vepër penale në vazhdim dhe njëkohësisht konsideron se dënimi i shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 7(shtatë) muaj dhe me gjobë në vlerë prej 600(gjashtëqind) euro është tejet i butë dhe në disproporcion të thellë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale dhe peshën e tyre. Shkelja e ligjit penal është bërë kur gjykata ka bërë kualifikimin e veprave penale në vepër penale në vazhdim pasi nuk janë plotësuar kushtet ligjore pasi i akuzuari ka pranuar kryerjen e 3 veprave penale si në aktakuzë dhe ai gjatë gjithë kohës ka pasur mbrojtës profesional, avokat. Aktgjykimi ankimohet nga ana e Prokurorisë edhe për shkak të vendimit mbi dënimin e shqiptuar, duke pretenduar se me këtë dënim nuk mund të arrihet efekti i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, dhe po ashtu dënimi është i ulët nëse merren parasysh rrezikshmëria e veprës penale, recidivizmi i të akuzuarit, dhe rrethanat e tjera rënduese.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ankimohet nga ana e mbrojtësit të të akuzuarit av.B.I. për shkak të vendimit mbi dënim duke vlerësuar se ka pasur hapësirë për një vlerësim më të favorshëm të rrethanave lehtësuese dhe për shqiptimin e një dënimit më të ulët, e kjo duke pasur parasysh pranimin e fajësisë, motivin e kryerjes

së kësaj veprë penale, sjelljen pas kryerjes së veprës penale duke pranuar veprën me sinqeritet , sjelljet korrekte gjatë tërë procedurës penale, është penduar dhe ka premtuar se asnjëherë nuk do të vjen ndesh me ligjin.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt, konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij. As gjendja faktike nuk qe objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, ngase nuk është kontestuar me ankesë, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në frymë të pretendimeve ankimore.

Kjo gjykatë ashtu edhe sikurse gjykata e shkallës së parë vlerëson se në rastin konkret janë plotësuar të gjitha kushtet e nevojshme që ndaj të akuzuarit të shpallet dënimi për veprën penale në vazhdim pasi që të dy veprat e para që kanë të bëjnë me narkotikë janë vepra penale të njëjta apo të ngjajshme të kryera në një lidhshmëri kohore nga i njëjti kryes dhe të së paku dy kushteve siç janë objekti i njejtë i veprës penale, situata e njejtë kohore, vendi apo hapësira e njejtë e kryerjes së veprës penale si dhe dashja e njejtë e kryesit prandaj pretendimi i Prokurorisë se në këtë rast kemi të bëjmë me shkelje të ligjit penal është i pabazuar.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me pretendimet ankimore të Prokurorisë dhe mbrojtësit të akuzuarit lidhur me vendimin për dënim kjo gjykatë konsideron se ankesat janë të pa bazuara. Në ankesa nuk ceket ndonjë rrethanë e re e që do të ndikonte në dënimin e shqiptuar apo të cilën nuk e ka pasur të njohur gjykata e shkallës së parë me rastin e vlerësimit të rrethanave që ndikojnë në lartësinë e dënimin, por theksohen vetëm ato pretendime të cekura më lartë ashtu që Gjykata e Apelit duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe atë pranimin e fajësisë dhe pendimin e të akuzuarit për veprat e kryera vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor, gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar dënimet nën minimumin e paraparë ligjor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 41 të KPRK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.291/2018, me 17.07.2018

Procesmbajtës,
Leonita Lajçi

Kryetarja e kolegjit
1. Tonka Berishaj

Anëtarët e kolegjit:

2. Dr.sc.Driton Muharemi

3.Have Haliti